



Datë: 02.02.2026

Numër Protokolli: 566/2026

A.nr.1995/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari anëtare, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1995/2025 të datës 08.12.2025, të parashtruar nga ankuesi A.E, kundër organit të punësimit: Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 02.02.2026 mori këtë:

V E N D I M

I. Hedhet poshtë si e palejuar ankesa më numër A.nr.1995/2025, e datës 08.12.2025, e parashtruar nga ankuesi, A.E.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.144/2025, i datës 25.11.2025, i Ministrit në detyrë të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, A.E (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), më datë 08.12.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me Nr.144/2025, të datës 25.12.2025, të Ministrit në detyrë të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 15.12.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale, ndërsa kjo e fundit më datë 19.12.2025, ka dorëzuar përgjigjen me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (tutje referuar Kolegji i Këshillit), ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 7751/2025, të datës 08.12.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit të datës 01.10.2014; Emalin e datës 27.11.2025; Emalin e datës 25.11.2025; Vendimin me NR.144/2025 të datës 25.11.2025; Vendimin me Nr.225/2025 të datës 25.11.2025; Kërkesën me numër protokolli 122/11/25 të datës 21.11.2025; Emalin e datës 21.11.2025; Vendimin me Nr.138/2025 të datës 21.11.2025 lidhur me zbatueshmërinë e vendimit të KPMSHCK-se; Vendimin me numër protokolli 7178/2025 të datës 05.11.2025 të KPMSHCK-se; Dokumentin e Identifikimit të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.12.2025; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1995/2025 të datës 19.12.2025; Përkrahimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme; Emalin e datës 17.12.2025; Kërkesën me numër protokolli 6125/2025 të datës 21.11.2025 për transferim të përhershëm; Vendimin me numër 6197/2025 të datës 25.11.2025;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesit është e palejuar, *sepse*;

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se, ankuesi sipas Akt emërimit të datës 01.10.2014, është i punësuar në pozitën e Drejtor i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme në Agjencinë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale. Ministri në detyrë i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me datë 08.07.2025, ka nxjerrë Vendimin me Nr.84/2025, përmes të cilit z. I.H, me pozitë Drejtor i Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore, e ka caktuar Ushtues të Drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale (*në tekstin e mëtejme referuar: AMMKM*). Kundër vendimit me Nr.84/2025 të datës 08.07.2025 ankuesi A.E ka parashtruar ankesë në Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, ndërsa, ky i fundit më vendimin A.nr.1444/2025 të datës 05.11.2025, ka aprovuar ankesën e ankuesit, ka anuluar Vendimin me Nr.84/2025 të datës 08.07.2025, duke obliguar Ministrin e Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit që ta zbatojë vendimin e këshillit brenda afatit 15 dite.

Me datë 21.11.2025 Ministri i Kulturës Rinisë dhe Sportit nxjerr vendimin me numër 138/2025 lidhur me zbatueshmërinë e vendimit të këshillit A.nr.1444/2025 të datës 05.11.2025. Me datë 25.11.2025 Sekretari i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit merr vendim për transferimin e përkohshme të nëpunësit I.H në pozitën e Drejtorit të Trashëgimisë në pozitën Drejtor i Departamentit për Planifikim, Projektim dhe Menaxhim të Komplekseve Memoriale, në kuadër të Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale.

Me datë 25.11.2025, Ministri në detyrë i MRKS-së më vendimin nr.144/2025, ka caktuar I.H në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Planifikim, Projektim dhe Menaxhim të Komplekseve Memoriale, si ushtues detyre të Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale.

Ankuesi kundërshton Vendimi nr.144/2025 të datës 25.11.2025 me pretendimin së vendim kontestues është i kundërligjshëm, pasi që kërkesa për transferim e I.H është nënshkruar nga Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore S.E. Shton se kërkesa për transferimin e I.H është në kundërshtim me vendimin për transferim pasi që kërkesa ka qenë për transferim të përhershëm ndërsa në vendim është transferim i përkohshëm, po ashtu vendimi i kontestuar lidhur me transferin e përkohshëm është në kundërshtim me Ligjin për Zyrtar Publik dhe Rregulloren për Transferim e Nëpunësve Civil. Kërkon që Këshilli të anuloi Vendimin Nr.144/2025, të datës 25.11.2025 lidhur me emërimin e ushtruesit të detyrës së I.H të Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memorial.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil*, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 124 ku përcaktohet se: 1. *Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...*”, dhe si rrjedhojë referuar dispozitave përkatëse ligjore Kolegji erdhi në përfundimin se me Vendimin Nr.225/2025 të datës 25.11.2025, për transferimin e përkohshëm të I.H, ankuesit nuk i është cenuar ndonjë e drejtë nga marrëdhënia e tij punës, sepse transferimi i përkohshëm i I.H ishte bërë në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Planifikim, Projektim dhe Menaxhim të Komplekseve Memoriale, ndërsa ankuesi mbanë pozitën e Drejtorit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme, kështu, që duke qenë se ankuesi me asnjë fakt nuk ka arritur të argumentoj pse një vendim i tillë ka cenuar të drejtat e tij, atëherë, në kuptim të këtyre rrethanave, në vlerësimin e Kolegjit ankesa është e papranueshme për shkak të mungesës së legjitimitetit të palës ankuese, kështu që, Këshilli nuk ka mundur të trajtoj në meritë ligjshmërinë e kontestuar nga ankuesi të Vendimit Nr.225/2025 e datës 25.11.2025 të Sekretarit të përgjithshëm të MKRS-se.

Andaj, nisur nga përcaktimi si me sipër, dhe duke qenë se sipas nenit 35 të Ligjit Nr.08/L-197, ndërlidhur me nenin 9 të Ligjit Nr.08/L-294 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, titullari në këtë rast ministri i MKRS-së posedon të drejtën e vlerësim diskrecional të emërimit të ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të AMMKM nga radhët e drejtoreshave të departamenteve brenda AMKM, atëherë, në vlerësimin e Kolegjit edhe me Vendimin Nr.144/2025 të datës 25.11.2025, të ministrit në detyrë të MRKS-së ankuesit nuk i është cenuar ndonjë e drejt nga marrëdhënia e tij e punës, kështu që, thënë si më sipër, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e ankuesit është e papranueshme në kuptim të nenit 129, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA, A.nr.1995/2025

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.E;
- Ministrit në detyrë të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në MKRS dhe AMMKM; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.